

## FJALA E GUVERNATORIT

Informacioni i marrë në analizë në këtë raport tregon se aktiviteti ekonomik ka ardhur në përmirësim gjatë muajve të verës, pas rënies së fortë të shënuar në tremujorin e dytë. Ky rikuperim pasqyroi lehtësimin e masave të distancimit social dhe mbështetjen e siguruar nga stimuli i gjithanshëm fiskal, monetar e makroprudencial. Megjithatë, pavarësisht tendencave pozitive, perspektiva e rikuperimit të ekonomisë në të ardhmen mbetet ende e brishtë. Vala e re e infektiveve dhe prezantimi i masave kufizuese në shumë vende, e potencialisht dhe në Shqipëri, paraqesin sfida serioze për shëndetin publik dhe për ecurinë e ekonomisë gjatë periudhës në vijim.

Në këtë kontekst, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vlerëson se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm. Kushtet monetare dhe normat e ulëta të interesit ofrojnë mbështetjen e duhur për rritjen ekonomike dhe për kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.

Pandemia ka dhënë një ndikim të fortë negativ në ekonominë shqiptare. Pasojat e saj janë materializuar qartë në treguesit kryesorë; masat e distancimit social dhe rritja e pasigurisë kanë sjellë tkurrjen e fortë të aktivitetit ekonomik, reduktimin e punësimit dhe rënien e inflacionit.

Inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një vlerë mesatare prej 1.4% në tremujorin e tretë, duke ardhur në ngadalësim nga një tremujor më parë. Reduktimi i tij i atribuohet kryesisht rënies së çmimeve të disa artikujve ushqimorë dhe të çmimeve të disa kategorive të shërbimeve. Në aspektin makroekonomik, rënia e inflacionit pasqyroi shuarjen e goditjeve të ofertës, presionet e ulëta të ardhura nga kërkesa e dobët agregate dhe tendencat dezinflacioniste në ekonominë tona partnere.

Sipas të dhënave të Instat-it, prodhimi i brendshëm bruto ra me 10.2% në tremujorin e dytë të vitit, duke shënuar tkurrjen më të fortë në historinë shqiptare të dy dekadave të fundit. Ky kontraktim rezultoi me bazë të gjerë në shpërndarjen sektoriale dhe strukturën e kërkesës agregate, por ai pasqyroi më së shumti tkurrjen e konsumit privat dhe të aktivitetit në sektorin e shërbimeve. Në të njëjtin tremujor, ekonomia shqiptare humbi rreth 50 mijë vende pune dhe shkalla e papunësisë u rrit në nivelin 11.9%. Megjithatë, paketat ndihmëse fiskale kanë amortizuar disi situatën e vështirë në tregun e punës. Për rrjedhojë, si rënia e punësimit dhe rritja e papunësisë kanë qenë më të zbutura se ecuria e treguesve të aktivitetit ekonomik.



Treguesit e disponuar për aktivitetin ekonomik dhe tregun e punës sinjalizojnë një rikuperim gradual gjatë tremujorit të tretë. Reduktimi i kufizimeve në qarkullimin e njerëzve dhe mallrave, në vend dhe në botë, ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit, si dhe përmirësimi i lehtë i treguesve të besimit, kanë krijuar premisat e nevojshme për rritjen e ekonomisë në të ardhmen. Megjithatë, rikuperimi ekonomik mbetet i brishtë dhe rreziqet janë e pritet të mbeten në kahun e poshtëm.

Skenari bazë i zhvillimeve të pritura është ndërtuar mbi supozimin e shmangies së masave ekstreme për kontrollin e përhapjes së një vale të dytë të pandemisë dhe reduktimin gradual të pasojave të saj. Në këtë skenar, ekonomia shqiptare pritet të shënojë një rënie të ndjeshme për vitin 2020 dhe norma relativisht të shpejta dhe të qëndrueshme rritjeje në vijim. Në përputhje me këtë skenar, inflacioni pritet të qëndrojë pranë niveleve aktuale në vitin në vazhdim. Më tej, rikthimi i aktivitetit ekonomik pranë potencialit do të krijojë kushtet për kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.

Stimuli i koordinuar fiskal, monetar dhe financiar, ka qenë një element vendimtar për zbutjen e pasojave të krizës.

Masat monetare dhe financiare të marra nga Banka e Shqipërisë kanë synuar furnizimin e plotë me likuiditet të tregjeve financiare, reduktimin e kostove të kreditimit dhe të shërbimit të borxhit, si dhe një ndarje sa më të përshtatshme të barrës financiare të krizës midis sektorit bankar dhe bizneseve e familjeve shqiptare. Nga ana tjetër, masat fiskale kanë synuar përballimin e emergjencës shëndetësore, rritjen e mbështetjes financiare për familjet në nevojë, si dhe lehtësimin e presionit fiskal mbi bizneset dhe përmirësimin e aksesit të tyre në kredi.

Tregjet financiare kanë reaguar pozitivisht ndaj masave të marra dhe transmetimi i stimullit monetar në ekonomi ka qenë i plotë. Normat e interesit të huamarrjes janë në nivele të ulëta, presionet për likuiditet janë të kontrolluara dhe kursi i këmbimit është i qëndrueshëm.

Sektori bankar ka akomoduar nevojat e kredimarrësve, duke ofruar shtyrje të përkohshme të kësteve të kredisë për klientët dhe ristrukturime tërësore të saj, dhe duke marrë mbi vete një pjesë të barrës financiare të krizës. Po ashtu, bankat kanë vijuar të kreditojnë ekonominë duke iu përgjigjur nevojave të sektorit privat për financim. Kredia për sektorin privat është rritur me rreth 6.3% në tremujorin e tretë, e mbështetur kryesisht nga kredia për biznese dhe ajo në lekë. Përtej stimullit monetar, ecuria e këtyre portofoleve është ndikuar pozitivisht nga masat rregullatore të marra nga Banka e Shqipërisë dhe skemat e garancisë sovrane. Ruajtja e qasjes pozitive të sektorit bankar ndaj kreditimit, do të jetë një parakusht i nevojshëm për rikuperimin e ekonomisë.

Në të njëjtën kohë, normalizimi i situatës ekonomike duhet të vijojë të mbështetet nga një kah stimulues i politikave ekonomike.



Duke gjykuar mbi projeksionet e skenarit bazë të Bankës së Shqipërisë dhe balancën e rreziqeve rreth tij, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vlerëson se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm. Norma bazë e interesit mbetet e pandryshuar në nivelin 0.50%.

Politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit të parashikimit për të siguruar kushte financimi të favorshme për rritjen e ekonomisë dhe për kthimin e inflacionit në objektiv.

Gjithsesi, zhvillimet e pritura makroekonomike janë të rrethuara nga pasiguri të shumta dhe të ekspozuara ndaj rreziqeve të kahut të poshtëm. Në veçanti, rreziqe të kahut të poshtëm burojnë nga:

- përkeqësimi i situatës epidemiologjike dhe thellimi i ndikimit të saj në ekonomi;
- shkalla e dëmtimit të kapaciteteve prodhuese, dhe mundësia e një rikuperimi më të ngadaltë të kërkesës së brendshme dhe asaj të huaj;
- lindja e vështirësive në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, në formën e rritjes së normave të interesit dhe kostove të financimit të sektorit privat, në formën e rritjes së ngadaltë të kredisë bankare, apo në formën e luhatjeve të forta të treguesve të tjerë të tregut financiar.

Materializimi i këtyre rreziqeve do të kërkonte lehtësimin e mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare.

